

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                             |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Tre vjet nga premtimi elektoral/ Kryebashkiaku i Kavajës, Fisnik Qosja, lë fshatrat pa ujë të pijshëm - REPORT.AL                                                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://report.al/tre-vjet-nga-premtimi-elektoral-kryebashkiaku-i-kavajes-fisnik-qosja-l-e-fshatrat-pa-uje-te-pijshem/">https://report.al/tre-vjet-nga-premtimi-elektoral-kryebashkiaku-i-kavajes-fisnik-qosja-l-e-fshatrat-pa-uje-te-pijshem/</a> |
| BURIMI  | report.al                                                                                                                                                                                                                                                   |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                      |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 19 shtator 2026, 17:06:16 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 17:05:38 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 66245de7338cf904fcce5ecde18fb5044bf2d4860a4a1c4958ac5e623f059310 |
| TEKSTI     | f8fff23a2fa13d631e0fe1933c85017e146a663e4c865177a929bc1d0f5b07a2 |
| PAMJA      | 912b7e9157297e2b39660109a330705f901ae033137343600e0188812ba2cefb |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 1eca56340e95e451e26eb72f152f73e14a7eb1688be064ef3e48cf3eeff6c241                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 54ed48543a6253cb20faf0026ba4de200ea88d62566e99edbe4b1e5f6894ea0c                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1eca56340e95e451e26eb72f152f73e14a7eb1688be064ef3e48cf3eeff6c241>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Home Aktualitet

# Tre vjet nga premtimi elektoral/ Kryebashkiaku i Kavajës, Fisnik Qosja, lë fshatrat pa ujë të pijshëm

by Bota Bota — September 19, 2026 in Aktualitet, Kryesore, Politike

0  
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Tre vjet pasi kryebashkiaku i Kavajës, Fisnik Qosja, premtoi furnizim 24 orë me ujë të pijshëm për fshatrat Karpen dhe Rrakull, banorët e intervistuar nga Faktoje në shtator 2026 thonë se vazhdojnë të marrin ujë nga pusët.

Bashkia Kavajë thotë se ka zbatuar si autoritet kontraktor një investim prej rreth 188.5 milionë lekësh për furnizimin me ujë të zonave bregdetare, ku përfshihet edhe Karpeni.

Por për furnizimin aktual, oraret dhe numrin e familjeve të lidhura në rrjet, institucioni ia kalon përgjegjësinë Ujësjellës Kanalizimeve.

## Premtimi

Në prag të zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, Fisnik Qosja **premtoi** zgjidhjen përfundimtare të furnizimit me ujë për Karpenin dhe Rrakullin.

*"Ne kemi një projekt që përfshin bashkë me Karpenin edhe fshatin Rrakull, i cili do të mundësojë furnizim 24 orë me ujë të pijshëm, aq të rëndësishëm për banorët dhe turizmin", deklaroi Qosja më 3 maj 2023.*

## TË FUNDIT

Tre vjet nga premtimi elektoral/ Kryebashkiaku i Kavajës, Fisnik Qosja, lë fshatrat pa ujë të pijshëm

SEPTEMBER 19, 2026

Kontrollet në sektorin ku mbahet Ergys Agasi/ Lala: Pati përplasje mes SPAK dhe Policisë së Burgjeve

SEPTEMBER 19, 2026

81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së/ Sala Jashari: Vendimi i Hagës është politik, aspak e drejtë për Kosovën!

SEPTEMBER 19, 2026

Steka cigaresh kontrabandë me autobus nga Shqipëria drejt Greqisë, procedohet shoferi, në 'lupë' edhe doganierët shqiptarë që e lanë të kalonte

SEPTEMBER 19, 2026

Kritikat nga Brukseli/ Rama zotohet nga Amerika: Në 2030-tën Shqipëria në BE!

SEPTEMBER 19, 2026

Si doli në skenë vila luksoze e Belinda Ballukut në Palasë? Klodiana Lala zbardh detajet

SEPTEMBER 19, 2026

Varret masive në Zubin Potok/ Identifikohen tre veprimtarë të njohur mes 23 personave të zhvarrosur në Mitrovicë

SEPTEMBER 19, 2026

Dogji mbeturinat, banori në Durrës i vë flakën lagjes 13, zjarri u afrohet banesave

SEPTEMBER 19, 2026

Protestë në Vlorë/ Qytetarët kundër muzeut hebraik

SEPTEMBER 19, 2026

Akuzat për falsifikim të dokumenteve dhe përfitim i padrejtë i pronave, arrestohet ish-drejtori i ASHK-së Fier dhe dy të tjerë

SEPTEMBER 19, 2026

### 3 Verifikimet

Faktoje e ka verifikuar këtë premtim çdo vit që prej 2023.

Në verifikimin e parë, Ujësjiellës Kanalizime Durrës konfirmoi se dy fshatrat nuk furnizoheshin 24 orë me ujë dhe se projekti ishte ende në hartim, ndërsa banorët e Rrakullit dhe Karpenit tregonin se përdornin puse dhe blinin ujë në pijshëm.

Në vitin 2024, Ujësjiellësi deklaroi se procesi për dy fshatrat ishte ende në fazën e studim-projektimit. Verifikimi në terren tregoi sërish se banorët mbështeteshin te puset.

Edhe në vitin 2025, situata e raportuar nga banorët mbeti e njëjtë: ujë nga puset për nevojat e përditshme dhe ujë i blerë për të pirë.

#### Bashkia Kavajë në 2026

Në përgjigjen e fundit për Faktoje, Bashkia Kavajë sqaron se ka pasur rolin e autoritetit kontraktor për zbatimin e punimeve fizike në kuadër të projektit "Furnizimi me ujë në zonat bregdetare, Plazhi i Gjeneralit – Bardhor – Karpen – Synej, Bashkia Kavajë, Varianti I, Loti I".

Vlera e kontratës është 188,549,796 lekë me TVSH dhe punimet janë zbatuar nga BOE "Boshnjaku B" sh.p.k. dhe "Desaret Company" sh.p.k.

Sipas Bashkisë, gjatë zbatimit projekti është ndryshuar për shkak të konfigurimit të terrenit, ndërsa kontrata është amenduar disa herë edhe për shkak të pretendimeve të banorëve mbi pronësinë dhe kundërshtimeve për vendosjen e linjave dhe puseve pranë pronave të tyre.

Por për të dhënat konkrete mbi furnizimin aktual me ujë, oraret dhe numrin e familjeve të lidhura në rrjet, Bashkia e drejton Faktoje te autoriteti operues i ujësjiellësit.

Faktoje iu drejtua edhe Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), por deri në momentin e publikimit nuk mori përgjigje.

#### Verifikimi në terren, shtator 2026

Më 4 shtator 2026, Faktoje u kthye në Rrakull dhe Karpen.

Në Rrakull, një banor rreth të 60-ave tha se familjet vazhdojnë të varen nga puset.

“Me ujin jemi shumë keq. Nuk ka ujë. Ne jetojmë me ujë pusi, atë përdorim. Kush ka ujë pusi të thellë është në rregull. Kush e ka të cekët, një sahat s’lag as bimët, as për t’u larë, as rrobat”, tha ai.

“Për ne është shumë problem i madh mungesa e ujit. Shpresojmë që një ditë qeveria t’i kthejë sytë nga ne”, shtoi banori.

Edhe në Karpen, një familje tregoi për Faktoje se ujin e siguronte nga pusi.

“Ujin e marrim përmes puseve që kemi vetë. Nga rubineti s’kemi ujë. Po na del uji i pusit tani, po edhe kur s’na del, çfarë të bëjmë?”, tha një banore.

Familjarët treguan se kush ka puse më të cekëta përballet me mungesë më të madhe uji dhe se kanë humbur besimin te premtimet për zgjidhjen e problemit.

**Përfundimi**

Në maj 2023, Fisnik Qosja premtoi furnizim 24 orë me ujë të pijshëm për Karpenin dhe Rrakullin.

Tre vjet më vonë, Bashkia raportoi se janë kryer punime në kuadër të një investimi që përfshin Karpenin, por nuk konfirmon se furnizimi 24-orësh është realizuar.


Verifikimi i Faktoje në terren më 4 shtator 2026 tregon se banorët e intervistuar në të dy fshatrat vazhdojnë të përdorin puse.

Në këto kushte, premtimi për furnizimin 24 orë me ujë të pijshëm të fshatrave Karpen dhe Rrakull mbetet i pambajtur. [/Faktoje.al](#)

Tags: bashkia kavaje fisnik qosja Ujë i pijshëm Zgjedhje

Previous Post

Kontrollet në sektorin ku mbahet Ergys  
Agasi/ Lala: Pati përplasje mes SPAK dhe  
Policisë së Burgjeve



Bota Bota

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



Parandalohet ngjarja e rëndë në  
Rrogozhinë, arrestohet i riu që  
kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

01

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e  
Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2  
zyrtarë në Tiranë

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.